



PROCESVERBAL

Mbledhja e 08 e Rregullt e Asamblese Komunale është në ora 10:00 në sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.
Në mbledhje kanë marrë pjesë 13 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtar të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 08 të rregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mbledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Shpërndarjen e Pajisjeve Bujqësore për Fermerët e Komunës së Mamushës për nder të Festivalit të Domatës.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullorës për taksa, tarifa, ngarkesa administrative dhe shërbimeve tjera komunale për vitin 2021.
5. Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2019
6. Të ndryshme

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po

13

-Jo

0

-abstenim 0

Me vota unanime procesverbali u pranua.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diçka me shtu në rend të ditës, urdhëro Z. Fuat.

Fuat Taç:

I nderuari kryetari i komunës na ka dhënë një premtim, por kanë kaluar 3-4 vite dhe nuk kemi mundur me marrë asnjë përgjigje për qështjen e xhamisë, kisha dashur me ditë se ku qëndron puna?

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Përshëndetje për të gjithë. Komuna e Mamushës e ka një vendim që e ka marrë para dy viteve për qështjen e xhamisë, ky vendim sipas kuvendit është akoma në fuqi por sipas planit zhvillimor komunal të komunës së Mamushës MAPL-ja akoma nuk aka lëshuar leje ndertimi për atë zonë . Komuna që dy vite është duke punuar në hartimin e hartave zonale dhe pa përfunduar kjo aty nyk mund të ndërtohet xhamia.

Nëse e marrim një vendim ai vendim do të shkojë në MAPL dhe ata prap do të na kthejnë përgjigje negative sepse ky nuk është një plan i cili mund të përfundon mbrenda një viti por varet edhe nga MMPH.

Fuat Taç

Ne këtu e kemi bërë një bisedë që ta bëjmë planifikimin dhe ta dërgojmë në Ministri.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Ne e kemi përfunduar atë planifikim dhe e kemi dorëzuar në Ministri. Pa kaluar në harta zonale ne nuk po mundemi të bëjmë asnjë ndryshim. Në vlerësimin dhe shqyrtimin e planit zhvillimor komunal ka dalë që në disa parcela apo zona duhet të bëhen disa ndryshime por këto ndryshime akoma nuk kanë përfunduar. Procedura po vazhdon.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Kryetar. A ka dikush diqka tjetër me shtu rreth buxhetit, urdhëro Z. Ilyas.

Ilyas Bayraktar:

Është nderuar Kryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit, siq e dini ne vendimin që e kemi marrë para dy viteve ajo zonë ka qenë zonë e gjelbërt dhe akoma figuron njëjtë por ne ta marrim edhe një vendim që ajo pjesë e gjelbërt të hapet për ndërtim. Është shumë e thjeshtë, ministrisë ia bashkangjesim këtë vendim edhe ky problem përfundon. Nuk keni nevojë qka me e bo kaq kجامet. Ministria është e obliguar që ta miratojë vendimin që e marrim ne nëse prona nuk është e shtetit, ajo pronë është e jonja dhe na vendosim për të. Për me hek nga zona e gjelbërt na duhet vetëm edhe një vendim i kuvendit edhe e dërgojmë në Ministri. Faleminderit

Buyar Mazrek:

Faleminderit Z. Ilyas. A ka dikush diqka tjetër me shtu rreth kësaj pike urdhëro Z. Yalçin.

Yalçin Mazrek:

Përshendetje për të gjithë, unë nuk desha me marrë fjalën porpasi që plani zhvillimor komunal është hartuar gjatë periudhës sa kam qenë unë drejtor dua ti jap disa sqarime. Ilyazi tha që merre një vendim edhe dërgoje në Ministri, një procedurë e tillë nuk egziston sepse plani Zhvillimor i komunës së Mamushës është një plan që zgjat 6 vjet, ka qenë një plan që ka filluar në mandatin para se me qenë unë drejtor dhe ka përfunduar sa kam qenë unë drejtor. Ju po thoni që ta marrim një vendim dhe ta ndërrojmë këtë plan, ky nuk plan që ndërrohet në moment por pasi që po e di se si qëndron puna po e përkrahi mendimin e kryetarit që pa kaluar në hartat zonale ne nuk mundemi të bëjmë asnjë ndryshim. Sepse ne hartimin e PZHK-së e kemi bërë në bashkëpunim me Ministrinë dhe e kemi kompletuar pas një procesi që ka zgjatur 6 vjet edhe nuk aka një vendim që mund ta ndërrojë punën e gjashtë viteve. Për këtë arsye pa përfunduar hartat zonale edhe nëse marrim ne ndonjë vendim ministria prap do na e refuzoj vetëm se do ta vëmë veten ë pozita të këqia. Kryetari tha që ne si komunë e kemi përfunduar, procesi ka ngelur tek ministria, vjen dita që edhe ata e përfundojnë edhe ne mandej mundemi me vazhdu me ndërtimin e xhamisë. Faleminderit.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Nëse thoni që të marrim vendim vetëm që të jetë vendim atëherë e marrim por mendoj që është gabim. Nëse doni jepna kohë një muaj dhe për mbledhjen e radhës prgaditemi më detalisht për procedurat deri ku kanë arritur dhe tek fundi fundit nuk e presim as hartat zonale por thojmë që varrezat tek parcela e caktuar duam ti shëndrojmë në zonë të ndërtimit. Unë kisha thënë që ta gjejmë edhe ligjin, nenin që e lejon këtë ndërtim e jo të veprojmë sipas kokës tonë. Faleminderit.

Ilyas Bayraktar:

I nderuar kryetar ne qe dy vite vazhdimisht u kemi dhënë kohë juve, qështja e dytë, kolegu tha që ka qenë një plan që ka zgjatur 6 vjet por unë nuk po tham që me e ndërru krejt planin zhvillimor komunal por vetëm atë vend me e shëndrru në zonë të ndërtimit, ne atë zonë e kemi përcaktuar dhe me vota unanime e kemi caktuar për ndërtim të xhamisë. Hartat zonale munden edhe 60 vjet me zgjatë por për me hapë atë pjesë mundet me zgjat 1 muaj. Për me bo ndryshim në PZHK duhet miratimi i kuvendit, ne këtë e kemi votuar por këtu po kërkohet që edhe një herë të votohet që të hiqet nga zona e gjelbërt dhe të shëndrrohet në zonë të ndërtimit. Ne po kërkojmë që vetëm një parcelë ta heqim nga ajo zonë dhe për këtë duhet vetëm një vendim. Ëedhte marrë një vendim më herët për caktimin e lokacionit por ai lokacion është zonë e gjelbërt por për ta nxjerrë këtë parcelë nga kjo zonë e gjelbërt na duhet edhe një vendim.

Yalçin Mazrek:

Por këtë nuk mundesh me nxjerrë vetëm me një vendim, duhet me e ndryshu planin zhvillimor komunal.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Unë nuk jam i obliguar me i zbatu rë gjitha vendimet që i merr kuvendi, diqka që është e jashtëligjshme nuk e zbatoj.

Ilyas Bayraktar:

I nderuar kryetar ju jeni i obliguar që ti zbatoni të gjitha vendimet që i mer kuvendi. Nëse nuk je atëherë shihemi në gjykatë

Fuat TAÇ:

Kryetar ne nëse nesër do të kërkonim që të ndërtojmë një shkollë ose ndonjë spital a duhet ky përcaktim i zonës, unë nuk po e kuptoj se përse po e zmadhon aq shumë këtë qështje kur nuk ke nevojë pse, sepse ti qysh po na tregon neve shembull një donator na ofron neve mjete për ndërtim dhe na qka do të bëjmë, do të presim të gjitha hartat e Kosovës le të ndërrohen mandej të fillojmë ndërtimin. Donatori na le neve edhe shkon diku tjetër, na nuk jem aq amatorë sa po mendo ni ju.

Ilyas Bayraktar:

I nderuar Z. Kryetar më herët ju keni shpërndarë në facebook që kemi ndarë buxhet për ta ndërtuar një spital por a lejohet ndërtimi? Nuk lejohet sepse është zonë e gjelbert.

Yalçin Mazrek:

Aty është zonë e ndërtimit, e di sepse unë kam punuar ne hartimin e PZHK-së.

Fuat Taç:

Ajo është pronë e komunës.

Yalçin Mazrek:

Po është pronë e komunës por ti e ke votuar në kuvend atë si zonë të ndërtimit ose tjetrën si zonë të gjelbërt.

Ilyas Bayraktar:

Ajo zonë është zonë e gjelbërt.

Yalçin Mazrek:

Jo İlyaz nuk është zonë e gjelbërt, ajo është zonë e ndërtimit pe di sjumë mirë.

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Të nderuar kolegë unë desha me ua treguar se qka mundemi të veprojmë sipas ligjit, tani juve ju ka mbetur që të merrni apo mos të merrni vendim. Është votuar buxheti i komunës por unë as nuk i kam fyer as nuk i kam lënduar anëtarët e kuvendit. Ti ke qenë kryesues i kuvendit 4 vite, a kemi mundur me i zbatu të gjitha vendimet që i ka marrë kuvendi, jo nuk kemi mundur sepse shkon në Ministri dhe pa kaluar nga miratimi i ministrisë asnjë vendim nuk hyn në fuqi. Ne këtë vendim e kemi marrë qe tri vite por nuk kemi mundur me e zbatu. Komuna për vendin që ka caktu për ndërtimin e shkollës nuk ka kurrfare problemi sepse ajo është zonë e lejuar për ndërtim. Në vendimin që ekemi marrë për caktimin e lokacionit të xhamisë ministria na ka kthyer përgjigje negative sepse ka kërkuar që të ndryshohen disa gjëra dhe ne keto gjëra nuk kemi mundur që ti ti ndryshojmë. Unë prap e respektoj vendimin e ju, mirret vendimi dërgohet në Ministri edhe ministria thot ok është në rregull ne normal që e zbatojmë por diqka që është kundër ligjshme atë nuk jam i obliguar që ta përkrahi sepse qdo përfundim të vendimit ministria na kthen neve dhe tregon arsyen nëse e kthen negativ. Kemi pasur raste kur 4 muaj e kemi votuar vendimin e njëjtë sepse ndodhnin gabime teknike ose ishin të kundërligjshme.

Buyar Mazrek:

Të nderuar anëtarë ne sot e marrim këtë vendim nuk është problem, por problemi është tek Ministria që mundet me na kthy negativ edhe ne mandej mundemi me ra ne pozita të këqija sepse vendimin e njejt na e kane kthyer negativ. Më mirë ta presim muajin e ardhshëm edhe e shohim se si është situata më mirë. Edhe kjo nuk ka vlerë nëse e marrim vendimin edhe na kthehet negativ nga Ministria.

Yalçin Mazrek:

Pasi që kemi pritur qe dy vite le të presim edhe një muaj. Vjen dikush nga drejtoria përkatëse edhe na spjegojnë detalisht se qka është bërë, qka do të bëhet, ku ka ngecur procesi, le të na tregojnë që ne e kemi bërë planifikimin, na duhet kaq kohë etj edhe ne mandej kqyrim se a duhet të mirret vendim apo jo?

Fuat tAÇ

Qe ni vit e gjys jemi duke pritur, sdi sa të kujtohet që unë së bashku me ty kemi protestuar këtu.

Yalçin Mazrek:

Edhe unë po tham pasi që kemi prit 1 vjet e gjysme të presim edhe një muaj. Pra vendimin që do e marrim sot nuk do të ketë kurrfarë efekti

Ilyas Bayraktar:

Është shumë e thjeshtë, vetëm atë zonë e shëndrro në zonë të ndërtimit.

Yalçin Mazrek:

Nuk është aq e thjeshtë si po thua ti, duhet të ndërrohet i tërë plani zhvillimor komunal dhe për këtë duhet të punojë drejtorja edhe duhet me ardhë me na tregu që ne këtë zonë po duam ta shëndërrojmë në zotë ndërtimit. Mandej ne nëse marrim vendim e dërgojmë në Ministri, pas dërgimit vijnë eksperte nga Ministria edhe e bëjnë analizën e tokës se a është e përshtatshme për ndërtim edhe fillojmë me ndërtim. Vendi është përcaktuar por kur na ka ardhur përgjigjenegative nga Ministria atëherë ne kemi thënë që ta ndryshojmë PZHK-në dhe kjo është ndryshuar veqse nuk po e dijmë se si është procedura, deri ku kanë shkuar punët. Kryetari i komunës e din ama nuk e din në detale se deri ku ka arritur procedura, këtë mundet me e ditë zyrtari që punon në atë drejtori. Unë kam qenë i pari që kam dashur që kjo xhami të ndërtohet edhe akoma jam por mos të marrim vendim të njëjtë dhe ministria të na kthej prap negativ.

Ilyas Bayraktar:

Na vendimin që e kemi marrë e kemi marrë vetëm për caktim të lokacionit dhe ministria na ka kthyer përgjigje që në parcelën që ju e keni zgjedhur për ndërtim të xhamisë është zonë e gjelbërt, Ministria nuk ka të drejtë të përzihet në tokat tona përdërisa nuk venprojmë kundër dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës. Ne po kërkojmë që ta shëndërrojmë vetëm një zonë.

Yalçin Mazrek:

Edhe nëse don me ndërru vetëm një metër katrorë duhet krejt PZHK-NË me ndërru edhe mundet me zgjat 6 vjet. Prizreni ka disa regjione kurse ne jemi vetëm një regjion edhe nëse duam ta ndërrojmë një zonë duhet ta ndërrojmë tërë Pzhk-në kurse Prizreni vetëm me një vendim mundet me ndërru.

Halim Sadiku:

I nderuar Z. Kryetar, Z. Komandant, anëtarë të kuvendit, kryetar unë e di që ju tash keni me shku mi bo hartat zonale në Gjermani atëherë na shembull si Asamble mundemi me definu ni ven jo te varrezat për shkak se edhe shkolla është afër. Xhamia i ka ato specifikat e veta sa duhet mu kon afer institucioneve shkollore edhe na mundemi për afërsisht me gjet ni ven edhe mos me bo shumë zhurmë edhe hartat zonale kanë mu bo këtë vit. Po qatyju ku e keni bo qat ven nështë problem për shah se ligji shkruan sa duhet mu kon kultet fetare larg institucioneve shtetërore. Kosova është shtet multietnik edhe ti ban xhamia, kisha, teqe, kerkush nuk të përzihet.

Ilyas Bayraktar:

Zoti Halim unë nuk po mundem me ju kuptu juve, na 14 anëtarë e kemi votuar ndërtimin e xhamisë dhe vetëm ju keni qenë kundër. Nëse ti je aq i bindur që para shkollës nuk mund të ndërtohen kultet fetare atëherë përse në mes të Prishtinës është ndërtuar kisha, përse nuk ke reaguar edhe përse po mundohesh me na shit men, nuk mundesh sepse na e kemi marrë vendimin dhe përveq teje na i përfaqësojmë 6000 qytetarë të Mamushës.

Halim Sadiku:

Vota 14 me 1 qka ka lidhje.

Ilyas Bayraktar:

Ti nuk mundesh me thon që smundesh me ndërtu sepse vendi është i joni, tokat janë tonat. Mos e zmadhoni aq shumë sepse as Ministria nuk mundet me dalë kundër kësaj. Na e kemi në dorë për me hek atë nga zona e gjelbërt. Në shumë vende ka xhamia afër shkollës, si në medvec, Zojz. Në medvec është

ndërtuar xhamia mbrenda në varreza, a e ke hapur gojën, jo. Nëse thoni që të presim edhe 1 muaj atëherë ne presim, nuk është problem.

Halim Sadiku:

Unë deshta me ju drejtu vetëm iljazit, unë nuk jam përfaqësues as i bashkësisë islame as i kishës ortodokse, unë jam përfaqësues i popullit, unë kum ardh me votë të popullit, nuk kum ardh me votë të asnjë kulti fetar, unë jam mysliman elhamdulillah, i besoj zotit. Unë nuk jam kundër sepse sa je ti mysliman jam edhe unë, asnjoni ma tepër as ma pak nuk mujna mu bo. O zotni i nderum unë nuk jam kundër xhamisë, veq me kap xhaminë në krah edhe meju tregu juve. Unë i mbroj interesat e komuniteteve pa marrë parasysh shqiptar, turk, ashkali.

Ilyas Bayraktar:

Kosova është shtet demokratik edhe na pasi që jetojme në Kosovë i dijmë pak a shumë se si qëndrojnë punët edhe ai vend e dijmë fort mirë se kujt i përket. Nëse ju kujtohet propozimin për këtë parcelë e ka propozuar Bujari. Më të lirë se komiteti Rom që jetojnë në Mamushë në asnjë vend të Kosovës nuk ka.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Kryetari na tha që në mujain e ardhshëm e marrim vendimin.

Kryetari i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Unë prej juve po kërkoj vetëm që të shikoj a ka ndonjë mundësi që ligjërisht qka mundemi me vepru, a kemi ndonjë mundësi ku mundemi me intervenu. Unë këtë po ua them që qdo vendim që mirret në kuvend kontrollohet nga institucionet më të larta të Kosovës. Vjen përgjigjja nga Prishtina që vendimin që e keni marrë ju në kuvend është i përshtatshëm në bazë të x ligjit, nenit qekaq shembull edhe ne mandej vazhdojmë me ndërtim. Nëse na thojnë me ndërru atëherë e ndërrojmë sepse këtu ka ndodhur që 5 herë e kemi votuar vendimin e njëjtë. Sipas ligjeve ka planifikime në komuna që kanë zgjatur më shumë se 6 vite. Unë një gjë po u them, edhe nëse bahen 50 xhamia askush nuk ka me qenë kundër. Të gjithë po mundohemi ta jetojmë myslimanizmin sipas mendimit tonë. Edhe një fëmijë 5 vjeçar nëse e pyet për ndërtim të xhamisë nëse ka 3 ose 5 euro ne dorë do ti dhuronte për xhami.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Edhe në kohën e juaj janë dhënë shumë premtime por nuk janë realizuar.

Ilyas Bayraktar:

I nderuar kryesues detyra jote është me udhëheqë kuvendin e jo me bo ndarje partish, ju lutemi kujdes fjalëve.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Unë nuk thashë asgjë, vetëm se disa premtime janë dhënë por nuk janë mbajtur.

Ilyas Bayraktar:

Kryetari tha që ta gjejme një rrugëdalje edhe të vazhdojmë por këtë rrugëdalje ne e kemi në dorë, skemi nevojë qka me prit.

Kryetari i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Në rregull Ilyaz tregom atëherë në bazë të cilit ligj, cilit nen mundemi me vazhdu më tutje. Unë patjetër duhet me zbatu vendimin që e merr kuvendi edhe që e kthen ministria. Unë nuk e zbatoj atë që nuk e aprovon Ministria, as nuk kam me zbatu.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

A po e lëmë për muajin tjetër këtë pikë apo po e vendosim këtë muaj?

Yalçin Mazrek:

Ilyazi po i thotë Qamilit që Kryetari po thotë ta lëmë për muajin e ardhshëm edhe muajin e ardhshëm kur të vijen thotë se ka aprovu Ministria atëherë edhe timundesh me e gjetë ligjin edhe kur thotë kryetari që me këtë ligj nuk po ban atëherë ti thuj që me ligjin që e kam gjetur unë ban, dëshmoje.

Ilyas Bayraktar:

Unë po tham që mbrenda universitetit është hapur xhamia.

Yalçin Mazrek:

Nuk është hapur, vetëm ndërtesa është ndërtuar por faljet nuk po bëhen, për shkak të afër është universiteti.

Ilyas Bayraktar:

Fshati mevec midis varrezave ka ndërtuar xhami, pse?

Yalçin Mazrek:

Sepse nuk ka shkollë përballë. Pika e rendit nuk është për shkollë por për shëndrrimin e zonës së gjelbërt në zonë ndërtimi.

Necmedin Morina:

Nëse kryetari i komunës kërkon një muaj kohë atëherë le tia japim, nuk kemi qka me diskutu aq gjatë.

Ilyas Bajraktar

Nëse mas një muaje thotë që nuk ban qka do të bëjmë?

Kryetarit i Komunës Z. Abdülhadi Krasniç:

Unë nuk po tham që bahet ose nuk bahet, nuk mundem me u premtu. Unë po them që nuk kemi nevojë me marrë vendime të kota, do ta shohim që ta shfrytëzojmë qdo mundësi që e kemi. Nëse unë nuk mundem me e gjetë ju tregoj a nëse ju e gjeni atëherë ejani dhe prezentojeni, marrim vendim edhe e zbatojmë. Unë po tham që të hulumtojmë edhe një muaj dhe ta shohim nëse kemi mundësi të gjejmë ndonjë ligj ku thotë që për shëndrrimin e zonës së gjelbërt në zonë ndërtimi duhet të ndërrohet e tërë PZHK-ja ose ndoshta ka edhe ndonjë ligj ku thotë që vetëm me një vendim të kuvendit mund të shëndrrohet në zonë ndërtimi. Për shkak se nuk po e di unë po du me hulumtu ma shumë.

Halim Sadiku:

Ju a jeni mirë nmen, me thon kta vendimin e njëjtë prap pe votojnë, se qaq fetar të mdhaj e kanë met pa u fal.

Ilyas Bajraktar

Propozimi im është që në atë zonë vetëm një parcelë të shëndrrohet në zonë ndërtimi. Ne le ta marrim vendimin edhe nëse e kthejnë ministria mrapa ska dert.

Yalçin Mazrek:

Ne kur e kemi marrë vendiminë parë për ndërtimin e xhamisë Halimi ka qenë kundër, këtë vendim e kemi dërguar në Ministri dhe Ministria për x arsyetim na kanë thënë që në atë parcel nuk mundeni me ndërtu xhami. Kryetari pas një ose dy muajve na ka spjeguar këtë. Por si do ta bëjmë këtë xhami, kryetari po thotë që duhet të bëhen ndryshime në PZHK, si duhet të bëhet ky ndryshim, kuvendi duhet të marrë vendim. Le të vjen dhe le të na thotë që Drejtoria i ka bërë punët dhe hulumtimet e duhura dhe në bazë të këtyre rezultateve mundemi me vazhdu më tutje ose të ndalemi. Mendimi im që muajin e ardhshëm le të vijë drejtoria edhe të na spjegoj që sa i përket vendimit që e keni marrë para 1 vit e gjysmë janë bërë këto punime, procesi ka vazhduar deri këtu, kjo është bërë, kjo nuk është bërë. Për këtë arsye unë jam kundër që ta marrim dy herë vendimin e njëjtë.

Ilyas Bajraktar

Është marrë një vendim për përcaktimin e parcelës dhe sipas shkresës që na është ardhur nga Ministria thotë që në këtë parcelë nuk mundet të bëhet ndërtimi sepse është zonë e gjelbërt. Nëse mirret edhe një vendim për ta shëndrruar në zonë ndërtimi atëherë ky problem do të mbarojë.

Yalçin Mazrek:

Po e kemi marrë edhe këtë vendim.

Ilyas Bajraktar

Jo nuk e kemi marrë. Për shëndrrimin e parcelës së vetme në zonë ndërtimi duhet edhe një vendim. Kujt i është parashtruar kërkesa për ndërtimin e xhamisë, komunës, kush e përcaktulokacionin, ju me gjithë ne, bile edhe në procesverbal shkruan që kam thënë tia japin një vend në atë zonë. Nehati pak mmë herët tha që une kam propozuar nga ana e shtepisë së tij ta ndërtojmë xhaminë por mua nuk po më kujtohet dhe kërkoj falje për këtë.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Atëherë kjo pikë le të mbetet për muajin e ardhshëm. Kalojmë tek pika e tretë që është

3.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Shpërndarjen e Pajisjeve Bujqësore për Fermerët e Komunës së Mamushës për nder të Festivalit të Domatës.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Për më tepër rreth kësaj qështje fjalën ia japim drejtorit për Financa Z. Türker Mazrek:

Türker Mazrek:

Përshendetje për të gjithë, siq e dini festivali i domates mbahet qdo vit me 23 korrik por këtë vit për shkak të pandemisë është shtyrë në një datë më vonë por për shkak të kryerjes së pagesave jemi detyrë që ta bëjmë shpërndarjen e mjeteve. Ndoshta nuk keni me dalë kundër për shkak se vendimi është marrë pas veprimi. Viteve tjera njëherë mirrej vendimi mandej bëhej shpërndarja por këtë vit për shkak të pandemisë ka pësuar ndryshime.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Faleminderit. Urdhëro z. İlyaz.

Ilyas Bajraktar

Sa i përket festivalit ka gabime të vogla kjo është shumë normale, por motokultivatorët që janë shpërndarë është dashur me qenë më kualitet, gabim është që një vend si Mamushës ku 80% e popullsisë mirret me bujqësi ti shpërndahen mallra kineze. Më mirë le të përfitojnë më pak bujq por le të jenë kualitet. Për freza dhe traktor nuk ka problem.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Atë që e thatë ju mall kinez, edhe nëse e merr atë mall ai prap pe shet. Kjo më shumë po më vret. Unë e kum pa atë ditë menjëherë 20 persona i kanë shitur motokultivatorët para meje, unë vitin e ardhshëm kisha propozuar që vitin e ardhshëm hiq mos ti dhurojmë. Afër 70,000€ nuk janë pak pare për Mamushën, sipas mendimit tim vitin e ardhshëm prap me i nda këto mjete është gabim sepse ne kemi mangësi në Mamushë si shembull ndriqimi etj. Mëkat është, personi pi merr frezat 700€ kurse po i shet 500€.

Nehat taÇ

Ilyas ju thatë që komuna e prizrenit ka shpërnda, unë e di mirë se si janë procedurat. Në këtë komunë marrin pjesë 30 % bujq, njëjte edhe komuna e rahovecit i ka ftuar tërë bujqit edhe i kanë pyetur që a don pllug apo taniraqë edhe të gjithë kanë marrë pjesë me përbindje. Asht më mirë që edhe na të veprojmë si ata.

Yalçin Mazrek:

Buyari tha që po i shesin, unë deshta me pyt drejtorin, nëse me pronarin që u është dhënë pajisja është lidhë kontratë, vetëm po du me dit që në atë kontratë a po shkruan që nuk mund ta shesë. Gabimi i ekzekutivit është që nuk e kanë cekur në kontratë që këtë pajisje nuk mund ta shesësh 2-3 vjetë, kjo është dhuratë edhe nëse e shet do të zbatohën këto ndëshkimë ligjore.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Unë kam thënë edhe në kuvend që ta dënojmë me 500€ kush e shet pajisjen dhe ju të gjithë keni qenë kundër.

Ilyas Bajraktar

Këto 70,000€ janë pakë për bujqit sepse 70-80% e Mamushës mirren me bujqësi, unë kisha propozuar që të ndajmë më tepër për ta. Sa i përket denimit që thatë nëse personi në fjalë e shet pajisjen atëherë nuk mund të marrë pjesë 5 vite atëherë dënimi më i madhë është ky.

Türker Mazrek:

Kjo qështje është diskutuar edhe në vitin 2018 kur kanë filluar për herë të parë të shpërndahen pajisjet që nuk mund të shitet pajisja, nëse shitet të monitorohet dhe të dënohet por shumica kanë qenë kundër kësaj. Komisioni ka thënë që mos të zbatohet një gjë e tillë, ne po ia japim ata le të bëjnë qka të dojnë me të. Nuk po mund ta di sa e logjikshme do të jetë kjo kur nuk e kemi zbatuar qe dy vite e me zbatu vetëm këtë vit.

Halim Sadiku :

I nderuar Z. Kryetar, të nderuar anëtarë të Asamblesë, sa i përket pajisjeve kjo është prej një prej mat mirav por është dashur me qenë një kriter që sa vite nuk mundet me e shit sepse ajo po i jipet për punë e jo për me shit. Këtu nuk asht fajtor asambleja, na e kemi marrë një vendim, e kemi nda një buxhet po në atë buxhet është dashur komunja, ekzekutivi me stafin e vet me qit një kriter, sa kohë smundet me e shit edhe mi majt gjithmonë nën kontroll personat që kanë marrë, mos me arrë dy herë, për shkak se na kemi shumë njerz që kanalizimi i shkonë në shpi me dy tri riga shiu edhe nuk mujna mi ndihmu ati qytetari. Aq

shumë punë ka Mamusha sa që buxhetin e ka shumë të vogël edhe nuk dish cilës mi dhon prioritet përpara. Në të ardhmen Mamushës i duhet një pregatitje e Asamblesë shumë ma e fortë, shumë ma e fuqishme që ekzekutivi mos të mundet me marrë vendime qysh don vet. Na jemi kta qetu që i kena votu 160,000€ i kena qu dam, ne jemi qeta qetu që i kena votu 190,000,00€, domethënë na jemi ata që e kemi qu buxhetin dam, na jemi. Ku e kemi qu buxhetin dam, 160,000€ e ki mbikqyrje të kanalizimev ajt ku janë, ku asht aj kamioni, unë nuk di qysh mujn mi bo ato faktura 160,000,00€. Tjetra e kemi aneksin e shkollës gjë që nuk kemi pas nevoj sepse nataliteti asht veq tu ra e jo tu u ngrit, ti nuk e ki ni shpi kulture, ni aktivitet sportiv. Qajo sallë sportive kish përfundu me 190,000,00€ kurse shkolla nuk përfundon me 500,000,00€. Ti ki shkoll boll, kjo është dobësia personalisht e jemja edhe e juja.

Ilyas Bajraktar

Na e kemi votu sepse ai e ka lyp nga ne.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Nëse nuk keni diqka me shtu atëherë votojmë për këtë pike.

Me vota unanime kjo pikë u votua.

Kalojmë në pikën e katërt

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Rregullorës për taksa, tarifa, ngarkesa administrative dhe shërbimeve tjera komunale për vitin 2021.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Nëse nuk keni diqka me shtu atëherë votojmë për këtë pike.

Me vota unanime kjo pikë u votua.

5.Raporti periodik per zbatimin e rekomandimeve për vitin 2019

Türker Mazrek:

Prap përshëndetje për të gjithë, raporti i auditimit të jashtëm është prezentuar në kuvend muajin e kaluar por para se te dërgohen ne Ministri duhet edhe njëherë të prezentohet në kuvend për diskutim. Këtu njëri ndër rekomandimet që e kanë bërë auditorët ka qenë që Komuna edhe në këtë vit, paratë e grumbulluara nga të hyrat nëpërmes arkës nuk i ka deponuar në llogarinëbankare me kohë. Parat e mbledhur prej datës 02.10.2019 deri me datën 29.11.2019 në vlerë prej 300€, janë deponuar në llogarinë e komunës me datë 02.12.2019 apo me 58 ditëvonesë por në sistem kjo po figuron 25 ditë me vonesë.

Ilyas Bayraktar

Në këtë prezantim ka pasur disa arsyeime, rekomandime, ju jeni përqëndruar vetëm te vonesa prej 58 ditëve.

Türker Mazrek:

Jo ne nuk jemi përqëndruar vetëm tek kjo vonesë por po hulumtojmë që mos është ndoshta gabimi i auditorëve. Sa i përket e pasurisë në proces e sipër.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Nëse nuk keni diqka me shtu atëherë kalojmë në të ndryshmet.

6. Të ndryshme

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar.
Faleminderit për pjesmarrje.

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek